

Në Thirrjen Nr. 4 LevizAlbania ka përfshirë për herë të parë procesin e VIJUESHMËRISË (upscaling), i cili i drejtohet të gjithë grantmarrësve të LevizAlbania, të cilët janë mbështetur në thirrjet e mëparshme për aplikime 1, 2 dhe 3. Qëllimi i drejtimit për vijueshmërinë ka në themel të tij objektivin për të mbështetur projekte të cilat kanë qenë të suksesshme në ndërhyrjet e tyre dhe kanë dhënë rezultate konkrete në forcimin e demokracisë vendore, rritjen e transparencës, llogaridhënies, pjesëmarrjes, përfshirjes në vendimmarrjet vendore.

## RREGULLAT DHE PROÇESI

### 1. Kush mund të aplikojë

- VETËM grantmarrësit e mëparshëm (OJF dhe individë) të LevizAlbania, të cilët kanë mbyllur në kohë dhe në përputhje me kushtet kontraktuale projektet e tyre.
- Organizatat (OJF-të) duhet të aplikojnë si koalicione ose rrjete me të paktën dy ose më shumë të tilla, ku njëra prej tyre do të jetë dhe organizata/aplikanti kryesor.
- Individët duhet të aplikojnë si grupime individësh.

### 2. Afati dhe mënyra e dorëzimit e aplikimeve

**Thirrja është e hapur nga data 11 Shtator deri në datën 29 Shtator 2017, ora 17:00.**

Aplikantët duhet të dërgojnë përmes postës zyrtare ose adresës elektronike [info@levizalbania.al](mailto:info@levizalbania.al) projekt-propozimin e plotë, kalendarin e aktiviteteve, buxhetin dhe dokumentacionin e kërkuar.

### 3. Drejtimi i Thirrjes

#### Drejtimi 4: Mbështetja e ndërhyrjeve strategjike të zbatuara nga LevizAlbania

Në këtë drejtim ftohen të aplikojnë OJF dhe Individë të cilët kanë ambicien për të ndikuar edhe më shumë duke:

- Nxitur pjesëmarrjen dhe advokimin nga të rinjtë në vendim-marrje nëpërmjet fuqizimit të tyre
- Forcimi i advokacisë dhe lobimit për çështje që lidhen me mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor
- Sigurimi i qëndrueshmërisë së mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës në nivel vendor

FINANCIAR NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicrane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

ZBATUAR NGA



FONDACIONI  
SHOQËRIA  
E HAPUR  
PËR SHQIPËRINË



PARTNERËT SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Co-PLAN

### 4. Dokumentacioni i kërkuar

- Projekt-propozimi i plotë, kalendari i aktiviteteve, buxheti;
- Marrëveshja e partneritetit të koalicioneve/rrjeteve për OJF-të;
- CV-të e të gjithë anëtarëve të stafit të projektit dhe ekspertëve që do të angazhohen;
- OJF-të që do të aplikojnë për këtë drejtim, qofshin këto organizata/aplikantë kryesorë apo pjesë të koalicioneve do të duhet të sjellin në aplikimin e tyre vendimin e fundit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, VETËM nëse kanë pasur ndryshime nga ajo e depozituar më parë pranë LevizAlbania.

### 5. Limiti i granteve

- Për këtë drejtim limiti maksimal i grantit të kërkuar është deri në 50.000 CHF për OJF dhe deri në 20.000 CHF për individë.
- Afati maksimal i zbatimit të projekteve është deri në 15 muaj.
- Në projekt-propozimin e plotë, OJF-të aplikuese do të duhet të paraqesin të integruar partneritetin me organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal.
- Në buxhetin dhe kalendarin e aktiviteteve për projekt-propozimet që do të vijnë nga OJF-të do të duhet të dalin qartë kostot dhe aktivitetet për secilin nga partnerët e koalicioneve/rrjeteve në nivel lokal.
- LevizAlbania zbaton për këtë drejtim, të njëjtat rregulla si më parë mbi natyrën dhe llojin e aktiviteteve si dhe për menaxhimin financiar.

### 6. Kriteret e Vlerësimit

**Kriteret më të rëndësishme për vlerësimin e projekt-propozimeve të plota janë:**


- Përputhja e projekt-propozimit me temat e drejtimit 4;
- Performanca e OJF-së/Individit gjatë zbatimit të projektit të mbështetur më parë nga LevizAlbania;
- Metodologjia e qartë dhe plani i realizimit të ndërhyrjes, përfshirja e bashkëpunëtorëve, numri i përfituesve, ndikimi në nivel vendor dhe kombëtar;
- Kosto/efiçenca dhe buxheti realist;
- Kapaciteti zbatues/menaxhues i koalicioneve, organizatave/aplikantëve kryesorë, organizatave partnere dhe i individëve;
- Vazhdimësia/qëndrueshmëria e mëtejshme e projektit, përhapja/ndarja e informacionit dhe e eksperiencës.

### 7. Hapat e thirrjes

Procedura e këtij drejtimi **NDRYSHON** nga ajo e tre drejtimeve të tjera të Thirrjes Nr. 4 të LevizAlbania.

Sesioni i informimit për këtë Drejtim do të zhillohet në datën 20 shtator 2017, ora 10.00 në “Hotel Opera”.

FINANCIUAR NGA



ZBATUAR NGA



Aplikantët do të duhet të paraqesin projekt-propozimin e plotë dhe Bordi i Granteve të LevizAlbania dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) do të marrin vendimin përfundimtar brenda një (1) muaji nga mbyllja e Thirrjes Nr. 4.

### 8. Fondet indikative për Drejtimin Nr. 4

Çfarë janë fondet indikative? LevizAlbania, në kuadër të transparencës informon aplikantët dhe të gjithë të interesuarit se fondet në dispozicion për nga drejtimin e katërt të Thirrjes për Aplikime, është si më poshtë:

Drejtimi Nr. 4 i Thirrjes	Limiti maksimal i grantit	Shuma në total
Mbështetja e ndërhyrjeve strategjike të zbatuara nga LevizAlbania	Maksimumi OJF: 50,000 CHF Maksimumi individë: 20,000 CHF	300,000 CHF

#### FINANCUAR NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

#### ZBATUAR NGA



FONDACIONI  
SHOQËRIA  
E HAPUR  
PËR SHQIPËRINË



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



**Co-PLAN**